



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.601/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj-Rugova, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, të parashtruar kundër subjektit politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.02.2025, merr këtë :

#### **V E N D I M**

**HEDHET E PASAFATSHME** ankesa Anr.601/2025 datë 20.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, kundër subjektit politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 20.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, të parashtruar kundër subjektit politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj me të cilën pretendojnë se ekziston dyshimi i arsyeshëm se kanë kryer veprat penale, subjekti politike dhe personat e propozuar në kallëzim penal kanë kryer veprat penale si më poshtë, dhe atë në mënyrë sistematike prej muajit Shtatorit 2024 deri me datë 9 Shkurt 2025, ashtu që kanë ndikuar drejtpërdrejtë tek votuesit, kanë dhënë ryshfet, kanë joshur votuesit dhe kanë kushtëzuar si dhe më e rënda kanë ndikuar direkt në përcaktimin e lirë të votuesve duke kryer këto vepra penale në mënyrë të orkestruar dhe ka dyshime se janë kryer këto vepra penale si në vijim si: vepra penale nga neni 209 paragrafi 2; *Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar*, Neni 212 *Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin* Neni 210 *Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve* Neni 213 *Keqpërdorimi i të drejtës së votimit* Neni

*215 Cenimi i fshehtësisë së votimit Neni 217 Asgjësimi i dokumenteve të votimit Kodit Penal të Republikës së Kosovës.*

Në vazhdim të ankesës theksojnë se nga muaji shtator 2024 deri më datë 09.02.2025, palët e përfshira kanë ndikuar në mënyrë sistematike në përcaktimin e lirë të votuesve, duke keqpërdorur të dhënat e tyre, duke shfrytëzuar mosdijenin e tyre dhe duke votuar për ta në votat e diasporës. Mëtutjue theksojnë se shembull tipik është fakti se në një koncert të organizuar nga PAI dhe shoqata "Rahmeti" ne Gjermani, përfaqësuesit e PAI kanë thirrë secilin person veçmas aty dhe kanë marr të dhënat personale, ku kanë hapur emailit e tyre dhe dëftesën e kanë pranuar në ato emaili të hapura nga këta përfaqësues dhe në momentin që ka ardhur dëftesa prej KQZ-së, nuk ka ardhur tek votuesi por tek ata persona që kanë pasur emailit e tyre, dhe votuesit nuk kanë pasur mundësi ta shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe dyshohet se këta persona kanë votuar për ta. Kjo formë e rrezikshme e cenimit të lirë të votuesve ka ndodhur në votat e diasporës dhe është bërë në mënyrë te orkestrimit.

Për ta vërtetuar faktin e orkestrimit të regjistrimit të votuesve në diasporë dhe ndikimin përfaqësuesve të PAI-të, kanë propozuar që prokurori i shtetit të merr në pyetje Milazim Shakolli, Besart Jashari, Artan Asllani, Diar Guxholli, Raif Kelmendi, Zekir Saldova, Etem Arifi, Xhemajl Asllani ( i arrestuar ditën e zgjedhjeve per manipulim te votave në Fushe Kosovë). Propozojnë që Etem Arifit dhe Besart Jashari, Artan Asllani (ish anëtar i KQZ-së, këshilltar aktual i Kryeministrit) ti merren telefonat dhe aty mund te gjinden komunikimet, hapjen e emailave per regjistrim dhe prova tjera lidhur me rastin konkret.

Parashtruesi i ankesës thekson se në këto zgjedhje parlamentare kanë hasur në situatë kur qytetarët janë detyruar ta përkrahin subjektin politik PAI, duke u shantazhuar nga OJQ RAHMETI, (me pretextin që ata të cilët nuk marrin pjesë në tubimet e PAI-së, dhe nuk e përkrahin PAI, nuk do të marrin ndihmën apo mbështetjen që organizata e tyre zakonisht e realizon si aktivitet humanitar), si dhe përveç asaj „PAI” dhe „OJQ RAHMETI ” kanë bashkëpunuar në mënyrë të hapur duke realizuar akvitetete politike (tubimet, fushatat) dhe akvitetet humanitare (shpërndarjen e ndihmës: dru dhe pako ushqimore).

Sipas parashtruesit të ankesës kjo përmban shkelje ligjore dhe si koalicion PDAK-LPB e kanë adresuar në PZAP përmes ankesës duke ofruar prova dhe argumente, me të PZAP merr vendim duke e dënuar Kandidatin e PAI-së z. Besart Jashari (Vendimin e ankesës kanë bashkangjitur si aneks shtesë në dokumentet e kësaj shkresë.)

Si provë ankesës ia ka bashkangjitur, Vendimin i PZAP-së me nr. Anr.236/2025 datë 30.01.2025, Video inqizimet mes Bajram Gashi dhe nipi të saj, Video inqizimi i Etem Arifi dhe Bekim Kryeziu; Fotot e (Besart Jashari Enver Topalli Ferizaj,) (Diar Guxholli fshati Hallaq Lipjan), Raif Kelmendi-Gjermani, Zekir Saliov-Gjermani, Naser Baftiu-Lipjan, Artan Asllani nga Fushë Kosova, fotot e Diasporës, Besart Jashari Ferizaj për përgatitjen e orkestrimit të votave në diasporë, Diar Guxholli nga fshati Hallaq Lipjan dhe Raif Kelmendi-Gjermani, Subjekti Politik, „PAI” duhet hetuar për okestrim te votave nga diaspora dhe cenimi e lire te votuesve, Subjekti Politik, „PAI” duhet hetuar për ndikimin në këtë organizatë, „PAI” duhet hetuar për blerje votash përmes pakove dhe shpërndarjes së druve dhe OJQ „RAHMETI” duhet hetuar aktiviteti i tyre për 4 vitet e fundit dhe Dëshmitar Bajram Gashi-Lipjan

Paneli pas vlerësimit të ankesës, konstaton se :

**- Ankesa është e pasafatshme.**

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP me datë 20.02.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullësi në mënyrë sistematike të votuesit nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve datë 09.02.2025.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, bazuar në nenin 119, paragrafi 1 të LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.02.2025, në ora 16:00, ndërsa parregullsitë me të cilin pretendon pala ankuese është nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve më datë 09.02.2025 lidhur me shkeljet e pretenduara, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, është parashtruar pas afatit ligjor të rregulluar me nenin 39, par. 3 të LZP, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar..."* ndërsa në nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, në mënyrë decisive thuhet se: *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj",* si dhe në nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet se *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 par.3, neni 119 paragrafi 1, neni 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
Anr.601/2025 datë 21.02.2025

**Kryesues i Panelit,**  
**Bujar Muzaqi**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.52/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Lumni Sallauka dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) LPB, me seli në Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.601/2025, të datës 21.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 27.02.2025, merr këtë:


### A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) LPB, me seli në Ferizaj, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.601/2025, të datës 21.02.2025, VERTETOHET.

### A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.601/2025, të datës 21.02.2025, është vendosur: Hedhet e pasafatshme ankesa Anr.601/2025 e datës 20.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) LPB, me seli në Ferizaj, kundër subjektit politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) LPB, me seli në Komuna Ferizaj, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet ankesa e koalicionit PDAK-LPB, të anulohen votat e Diasporës ose pezullohen deri sa nuk kryhet një hetim nga prokuroria si dhe të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në PZAP.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) LPB, me seli në Komuna Ferizaj, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të hedhet poshtë si e pas afatshme ose të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.601/2025, i datës 21.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 20.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, të parashtruar kundër subjektit politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj.

Duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, PZAP-i, ka nxjerr vendimin A.nr.601/2025, të datës 21.02.2025, me të cilën e ka hedhur ankesën si të pas afatshme, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP më datë 20.02.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në mënyrë sistematike te votuesit nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve datë 09.02.2025. Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, bazuar në nenin 119, paragrafi 1 të LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.02.2025, në ora 16:00, ndërsa parregullsitë me të cilin pretendon pala ankuese është nga muaji shtator 2024, deri në ditën e zgjedhjeve më datë 09.02.2025 lidhur me shkeljet e pretenduara, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli Ferizaj, është parashtruar pas afatit ligjor të rregulluar me nenin 39, par. 3 të LZP, në të cilin nën në mënyrë decisive thuhet se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur



për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar..." ndërsa në nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, në mënyrë decisive thuhet se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrijë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj, si dhe në nenin 13, paragrafi 3. nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet se "PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.02.2025, në ora 16:00, ndërsa parregullsitë me të cilin pretendon pala ankuese janë nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve më datë 09.02.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit ligjor të paraparë me nenin 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së.

Me nenin 39 paragrafi 3 përcaktohet se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i do të vendosë për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj".



Me nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, me të cilin përcaktohet se: “ Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrijë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”. Prandaj nga kjo rrjedhe se vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Me nenin 13 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, me të cilën përcaktohet se: “ PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.3. nuk është dorëzuar në afatit e paraparë ligjor”.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) – LPB, se PZAP, gabimisht ka vendosur kur e ka hedhë si të pasafatshme ankesën, për faktin se votat e diasporës ende nuk kanë filluar të numërohen, Gjykata Supreme vlerëson se ky pretendim është në tërësi i pa bazuar. Në rastin konkret është irelevante se kur fillon numërimi i votave, nëse pretendimi i shkeljes është pretenduar se ka ndodhur para procesit të numërimit të votave, ndërsa sipas pretendimeve në ankesë shihet qartë se shkeljet e pretenduara nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, se PZAP, pretendohen se janë bërë nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve më datë 09.02.2025, ndërsa ankesën në PZAP, ky subjekt e ka dorëzuar më datë 20.02.2025, që rezulton se ankesa është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orëve, andaj me të drejtë PZAP e ka hedhë poshtë ankesën si të pas afatshme.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.52/2025, datë 27.02.2025.

Kryetarja e kolegjit,

Muhamet Rexha



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlaščeni radnik